

PËRFUNDOJNË PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË APLIKANTËVE NË THIRRJEN E VIII TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS



Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët shpalli më 1 qershor Thirrjen e VIII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, e cila qëndroi e hapur deri më 5 korrik dhe ofroi plot 1,612 pozicione vakante prej të cilave 704 në administratën shtetërore, 560 në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 94 në institucionet e pavarura, 175 në shoqëritë tregtare dhe 79 në organizatat jofitimprurëse. **Aplikimet për Thirrjen e VIII, u mbyllën me sukses më 5 korrik, me plot 1,327 aplikime** nga të rinjtë të moshës 21-26 vjeç që duan të zhvillojnë karrierën në vendin e tyre.

Përgjatë muajit korrik dhe gusht, kanë vijuar procedurat për vlerësimin e aplikantëve nga institucionet pritëse. Kandidatët e përzgjedhur janë njoftuar nga institucionet përkatëse dhe **kanë filluar procedurat për të nënshkruar marrëveshjen për zhvillimin e praktikës profesionale 3-mujore, nga data 1 shtator deri më 1 dhjetor 2023, e cila njihet si përvojë pune nga DAP.** Të rinjtë e vlerësuar me pikë maksimale, do të kenë mundësinë të punësohen me kontratë 1-vjeçare në bazë të performancës së tyre dhe nevojave të institucioneve pritëse.

HAPET THIRRJA PËR APLIKIME PËR "RIN CAMP 2023"

Më 15 gusht, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, Unicef Albania dhe World Vision Albania, kanë shpallur **thirrjen për aplikime në "Rin Camp 2023"**, qëllimi i të cilit është të ndihmojë të rinjtë të zgjerojnë horizontet e tyre, të zhvillojnë aftësi të reja, si dhe të krijojnë miqësi për të ardhmen, duke rritur kështu cilësinë e jetesës së tyre.

Gjatë katër ditëve të kampit, që do të zhvillohet nga data **31 gusht deri më 3 shtator**, do të jenë të pranishëm edhe profesionistë të fushave përkatëse dhe biznese që do të informojnë të rinjtë rreth mundësive të ndryshme për ndërlidhjen me tregun e punës; digjitalizimin e vendit të punës dhe arsimit; kërkimin shkencor në arsimin e lartë; strukturat studentore; zhvillimin e aftësive të lidërshiptit, aftësive ndërpersonale dhe aftësive të buta; si dhe të socializohen e të njihen me të rinj nga e gjithë Shqipëria.





HAPEN APLIKIMET PËR TË GJITHË TË RINJË 15-19 VJEÇ PËR TË PËRFAQËSUAR SHQIPËRINË NË CODEWEEK

Shqipëria është përzgjedhur nga EU Codeweek si një ndër 6 shtetet fituese për të zhvilluar për herë të parë një hackathon me të tilla përmasa me mbështetjen e Komisionit Evropian. Gjatë këtij muaji, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në

bashkëpunim me Albanian ICT Academy dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë hapen aplikimet për të gjithë individët 15-19 vjeç të pasionuar pas teknologjisë që zotërojnë njohuri dhe aftësi në fusha si STEM, shkencë kompjuterike, dizajnim, inxhinieri dhe TIK, për të përfaqësuar Shqipërinë në tre ditët maratonë, nga data 8 deri më 10 shtator, ku do të zhvillohen 10 sfida në nivel ndërkombëtar dhe më pas grupet fituese do të bëhen pjesë e hackathon-it ndërkombëtar që do të zhvillohet në muajin tetor në Bruksel.

VIZITA E DELEGACIONIT JAPONEZ NË SHQIPËRI

Më datë 28 gusht, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti Delegacionin Japonez me përfaqësues z. Hirai Takuya, ish-Ministër i Digjitalizimit për dy mandate radhazi, krijuesi i Agjencisë Digjitale të Japonisë, momentalisht Anëtar i Grupit të Miqësisë Japoni-Shqipëri dhe Kryetari i Delegacionit; z. Miyake Shinichiro, President & CEO i NTT Data Luweave Corporation; z. Murai Jun, Profesor në Universitetin Keio dhe administrator i njohur si "Babai i internetit në Japoni"; z. Ogiwara Norio dhe z. Okui Noriaki, të dy përfaqësues nga kompani prestigjioze teknologjike, si dhe Ambasadorin e Japonisë në Shqipëri z. Takada Mitsuyuki, me të cilët biseduan gjerësisht për programet që po zbatohen për fëmijët dhe të rinjtë, duke u ndalur specifikisht në programet rreth teknologjisë, si edhe u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit për të zhvilluar më tej këto programe, për të sjellë risi në mënyrën e implementimit dhe kurseve që ofrohen.

Gjithashtu, Delegacioni Japonez përveç se evidentoi potencialin e zhvillimit që Shqipëria ka në fushën e teknologjisë, ndau edhe eksperiencën e tyre mbi zhvillimet teknologjike më të fundit në Japoni që lidhen me fëmijët dhe të rinjtë. Ndër të tjera, interes të veçantë shprehën edhe për programin "Jashtë Orarit Mësimor" dhe nivelin e dytë të tij, që do të fillojë implementimin së shpejti.



ZBATIMI I PROJEKTIT "RINIA PËR SHËNDE TIN MENDOR"

Projekti "Rinia për Shëndetin Mendor" është një nga 24 projektet fituese të Thirrjes së Dytë për projekt-propozime për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Ky projekt ka si qëllim edukimin e të rinjve të Bashkive Fier e Kamëz, për shëndetin mendor së bashku me vullnetarizmin në komunitet dhe kontributin që të rinjtë mund të japin në luftën kundër stigmës që lidhet me çështjet e shëndetit mendor. Implementimi i këtij projekti me fokus të rinjtë dhe shëndetin mendor është shtrirë në disa sfera të jetës së përditshme të të rinjve. Aktualisht, në kuadër të projektit, **organizata po zhvillon një fushatë sensibilizuese mbi shëndetin mendor në internet si dhe ka publikuar një manual mbi kujdesin për shëndetin mendor për të rinjtë.** Implementimin e shpejti.



EKIPI SHQIPTAR I ROBOTIKËS DO TË PËRFAQËSOJË SHQIPËRINË NË FIRST 2023

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti Ekipin Shqiptar të Robotikës, të cilët prej gjashtë vitesh kanë përfaqësuar denjësisht Shqipërinë në First Global Challenge, kompeticionin e robotikës me 14 sfida inxhinierike që lidhen me problemet mjedisore që kërcënojnë botën. Ekipi Shqiptar i Robotikës ka përfaqësuar vendin në edicionet e konkursit prej gjashtë vitesh, ku edhe **kanë siguruar medalje në disa prej tyre, krah të rinjve nga e gjithë bota.** Këtë vit, Ekipi Shqiptar i Robotikës do të marrë pjesë në FIRST 2023 që do të zhvillohet në tetor në Singapor, ku Shqipëria do të përfaqësohet nga 8 të rinj të talentuar dhe të apasionuar pas teknologjisë.

STUDENTËT NGA NORTH EASTERN UNIVERSITY, SHBA JAPIN KËNDVËSHTRIMIN E TYRE PËR POLITIKËBËRJEN PËR TË RINJTË NË SHQIPËRI

Në një takim me 25 studentë nga North Eastern University SHBA, profesorin e tyre z. Denis Sullivan dhe z. Benard Zeneli, ekspert i jashtëm i SKR29, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ndau vizionin e qeverisë shqiptare për fuqizimin e të rinjve në çdo fushë të jetës, duke u prezantuar atyre Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Strategjia u mirëprit me vlerësim të lartë nga studentët dhe profesori, të cilët e shohin si një mundësi të jashtëzakonshme për të përmirësuar perspektivat dhe jetën e të rinjve shqiptarë. **Këndvështrimi i studentëve për politikëbërjen për të rinjtë në Shqipëri dha një shembull të mrekullueshëm se si të rinjtë mund të bëhen partnerë të vlefshëm në ndryshimet pozitive shoqërore.**



FINALIZOHET NJË TJETËR PROJEKT NGA THIRRJA E DYTË E AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË, "AFTËSIM DHE PUNËSIM PËR TË RINJTË"

"Aftësim dhe Punësim për të rinjtë" është një nga projektet fituese të Thirrjes së Dytë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, i zbatuar po me mbështetjen e AKR-së. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në ceremoninë përmbyllëse të projektit të zbatuar nga Unioni i Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë që u mbajt më datë 29 gusht. **Projekti ka promovuar punësimin e të rinjve, si dhe ka rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e punësimit.** Gjatë ceremonisë, të rinjtë pjesëmarrës në projekt u pajisën me certifikata për tre komponentët kryesorë të projektit: programi i trajnimeve, praktikat e punës dhe programi i mentorimit.

